




SIGAL



UNIQA GROUP AUSTRIA



The insurance of a new generation!



Raport
Vjetor
Annual
Report

2008



SIGAL
Holding
Kompania më e
madhe e sigurimeve
në Shqipëri!



UNIQA GROUP AUSTRIA

Kompania lider në
Europën Qendrore
dhe Lindore

Përmbledhje

Faqja

Harta e Mbulimit	UNIQA GROUP AUSTRIA dhe SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA	05
Fjala Përshëndetëse	Jeffrey GRIFFIN, Kryetar Bordi Mbikëqyrës, SIGAL Holding Andreas BRANDSTTETER, Anëtar Bordi Menaxhues, UNIQA GROUP AUSTRIA Avni PONARI, Drejtor i Përgjithshëm, CEO, SIGAL Holding	06
Rreth Kompanisë	Misioni i SIGAL Holding Etapat e zhvillimit të kompanisë Sukses përmes bashkëpunimit me aktorë ndërkombëtarë	11
Ngjarje të Rëndësishme për vitin 2008	Çmime ndërkombëtare për vitin 2008 SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Kosova mbush 5 vjet SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Maqedoni përruron zyrat e reja në Shkup Krijohet fondi i ndihmës për Gërdecin Konferenca e 5-të Rajonale në Egjipt	14
SIGAL Holding në shifra dhe fakte	SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Jo Jetë Shqipëri SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Life SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Kosova SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Maqedoni	17
Të dhëna Financiar: numër kontratash, primesh sipas degëve dhe produkteve		26
Parashikimet për 2009		35
Produktet Sigurimi të hedhura në treg gjatë 2008	Sigurimi Privat i Shëndetit Sigurimet e Jetës me Kursim	40

Contents

Page

Broad Coverage	UNIQA GROUP AUSTRIA and SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA	43
Forewords	Jeffrey GRIFFIN, Chairman of Supervision Board of SIGAL Holding Andreas BRANDSTTETER, Member of Management Board, UNIQA GROUP AUSTRIA Avni PONARI, CEO, SIGAL Holding	44
About the Company	Mission of SIGAL Holding Development steps of the Company Success through the cooperation with international actors	49
Important Events for 2008	International awards for 2008 SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Kosova to its fifth year of existence New branches in Skopje and other Macedonian cities Establishment of Gërdec's emergency fund The 5 th Regional Conference in Egypt	52
SIGAL Holding	SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Non Life Albania SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Life SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Kosova SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Macedonia	55
Financial Data: contracts, premium volume for branch, premium volume per product etc.		26
2009 Forecast		35
Insurance Products launched on 2008	Private Health Insurance Life Insurance with Long-terms Deposit	64
Contacts		66

Harta e Mbulimit



24 shtete ku operon
UNIQA GROUP AUSTRIA

SIGAL Holding	Vëllimi i Primeve 2008	Përfitimi Neto 2008	Nr. I Policia deri në 31.12.2008	ROE (Return on Equity)	Nr. Degë	Agjentë/ Agjenci	Punonjës 2008
SIGAL (Jo Jetë dhe Risigurime)	€ 14.544.790	€ 1.854.846	156.293	14%	24	385	116
SIGAL Life	€ 1.701.580	€ 597.753	13.989	15.8%	15	52	14
SIGAL Kosova	€ 6.085.367	€ 605.767	43.010	16.8%	6	38	56
SIGAL Maqedoni	€ 5.331.950	€ 383.941	53.762	9.6%	17	157	58

Të dashur aksionerë,

Viti 2008 ishte sërish një vit arritjesh për SIGAL Holding sh.a dhe për kompanitë që e përbëjnë atë. Arritjet e kompanisë janë shumë domethënëse nëse bëhet krahasimi me kompanitë tjera sigurimi në Europën Lindore dhe më gjerë. Ndërkohë që pjesa tjetër e botës përjetoj efektet e krizës së kreditit dhe recensionit i cili u shtri në të gjithë Europën dhe Amerikën, SIGAL Holding ka ecur përpara duke rritur volumin e primeve të shkruara dhe fitimin. Në të njëjtën kohë, SIGAL Holding ka shtuar rezervat dhe kapitalin duke tejkuluar kështu të gjitha kërkesat për kapitalin dhe duke ia shtuar atë rezervave. Kjo rritje e vazhdueshme nuk ka ardhur rastësisht pasi SIGAL Holding është drejtuar nga një staf menaxhues i suksesshëm i kryesuar nga z. Avni Ponari si dhe ka vazhduar të vërë theksin tek trajnimi i personelit dhe udhëzimet mbi produktet dhe shërbimet e reja.


Për më tepër, largpamësia e SIGAL Holding e shprehur në bashkëpunimin strategjik me UNIQA Insurance Group Austria në vitin 2007, e ka orientuar edhe më shumë SIGAL Holding duke i mundësuar shembujt dhe produktet më të fundit të kësaj industrie. Marrëveshja me UNIQA-ën për të blerë shumicën e aksioneve të SIGAL Holding (këtë vit UNIQA bleu 46% të aksioneve të SIGAL Holding dhe sipas marrëveshjes do të blejë pjesën e mbetur të aksioneve në vitet në vazhdim), i ka mundësuar SIGAL Holding më shumë fuqi financiare dhe ne e presim të ardhmen si anëtarë



të UNIQA Insurance Group Austria.

“Ne besojmë se viti 2009 do të shënojë arritje të tjera dhe do të bëjmë maksimumin për të realizuar qëllimin.”

Jeffrey GRIFFIN




Kryetar Bordi Mbikëqyrës
SIGAL Holding

Të dashur klientë dhe partnerë biznesi, Të dashur zonja dhe zotërinj,

Viti financiar 2008 u karakterizua nga ngadalësimi dramatik që solli kriza ekonomike në tregjet kryesore dhe për pasojë edhe përkeqësim të kushteve ekonomike jashtë sektorit financiar. Supozohet se ekonomia botërore do të vazhdojë të vuajë pasojat e krizës edhe përgjatë vitit financiar 2009 dhe se do të na duhet të presim për disa kohë për daljen nga kriza. Pavarësisht kësaj, është e rëndësishme të mbajmë parasysh se qeveritë kudo në botë janë të ndërgjegjshme për sfidat e reja që ka sjellë kriza aktuale ekonomike dhe po investojnë pafundësisht fonde me synim ndalimin e rënies ekonomike dhe motivimin e rritjes. Efektet e këtyre programeve do të jenë pika kyçe për të orientuar ekonominë botërore drejt rritjes.

Përsa i përket UNIQA GROUP AUSTRIA, viti i kaluar financiar konfirmoi sërish saktësinë e strategjisë sonë për shtrirjen e gjerë rajonale të biznesit. Edhe pse rënia e ekonomisë botërore ka ndikuar në nivele të ndryshme vendet e Europës Qëndrore dhe Lindore, grupi UNIQA dhe vendimmarrësit në nivel European duhet dhe do të mbështesin këto vende për të përballuar krizën dhe për të punuar për arritjen e zhvillimeve pozitive dhe të pandërprera ekonomike.

Në kushtet e një mjedisi të vështirë botëror, SIGAL UNIQA Group Austria si lider i tregut kreu sërish, sikurse gjatë viteve të mëparshme, një punë shumë të mirë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni duke vendosur sërish standarde të reja



ndërkombëtare në të gjithë rajonin. UNIQA GROUP AUSTRIA si aksioneri kryesor dëshiron të falënderojë për këtë, Drejtorin e Përgjithshëm dhe aksionerin z. Avni Ponari, stafin drejtues dhe të gjithë punonjësit për efektshmërinë e arritur, përkushtimin dhe punën energjike të kryer. Kompetencat, fleksibiliteti dhe gatishmëria e kolegëve dhe partnerëve tanë lokalë në punën e tyre të përditshme janë kushtet kryesore për të siguruar shërbime dhe produkte të një cilësie të lartë për klientët tanë, duke arritur në këtë mënyrë synime ambicioze.

Andreas BRANDSTETTER

Anëtar Bordi Menaxhues
UNIQA GROUP AUSTRIA


Të dashur miq, klientë dhe partnerë të SIGAL Holding,

Viti financiar 2008, konfirmoi për të disatin vit rradhazi efektshmërinë e vizionit, strategjisë dhe përkushtimit të SIGAL Holding në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve gjithnjë e më shumë cilësore dhe inovative në tregjet ku operon.

Gjatë vitit 2008, pavarësisht krizës globale që përfshiu ekonominë botërore, SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA, Shoqëria më e Madhe e Sigurimeve në Shqipëri, e shtrirë në Kosovë dhe Maqedoni dhe pjesë e njërit prej grupeve më të mëdha financiare në Europë, pati një rritje të volumit të përgjithshëm të primeve për 2008-ën ishte 17% duke arritur vlerën prej 27,751,720 Euro.

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA, vazhdoi kryesimin e saj në tregun shqiptar të sigurimeve duke zotëruar 27.2% të tij për aktivitetin e Jo-Jetës ndërkohë që SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Life zotëroi 40% të tregut për produktet e Sigurimit të Jetës.

Përmes 50 degëve dhe mbi 500 agjencive në të gjithë rrjetin e saj të shtrirjes është konfirmuar tashmë se është Shoqëria më e madhe e Sigurimeve në Shqipëri e cila po rritet shpejt dhe njësoj suksesshëm edhe në Kosovë dhe Maqedoni. Më konkretisht, gjatë vitit 2008 Kompania pati një rritje prej 13% në Kosovë dhe 12% në Maqedoni duke qenë në këtë mënyrë inovative në tregun rajonal.



Avni PONARI
Drejtore i Përgjithshëm,
CEO, SIGAL Holding

Një shtrirje dhe sukses i tillë është vlerësuar në shkallë ndërkombëtare përmes vlerësimit për të katërtin vit rradhazi nga Financial Central Europe si "Shoqëria më e Mirë e Sigurimeve në Shqipëri".

Progresi i SIGAL Holding është tashmë produkt i eksperiencës dhe vizionit të gjerë që stafi i Kompanisë ka për zhvillimin dhe herdhjen në treg të produkteve të sigurimit në emër të mirëqenies dhe cilësisë së jetës për klientët e saj. Falë bashkëpunimit me UNIQA GROUP AUSTRIA dhe ndërtimit të një sipërmarrjeje të suksesshme gjatë viteve të kaluara, SIGAL Holding është e pozicionuar në mënyrë të shkëlqyer për të përfutur nga eksperiencia e saj mbi 100 vjeçare, gjithashtu

“Progresi i SIGAL Holding është tashmë produkt i eksperiencës dhe vizionit të gjerë që Kompania ka për zhvillimin e mëtejshëm të produkteve të sigurimit në emër të mirëqenies dhe cilësisë së jetës për klientët e saj”.

nga eksperiencat më të mira të të gjithë rajoneve ku operon UNIQA GROUP AUSTRIA dhe nga kjo epokë e re që po fillon për tregjet e sigurimeve në Ballkan.

Por pavarësisht pozicionimit si kryesuesit e tregut, nuk do të thotë që jemi të kënaqur apo që duhet të mjaftohemi me kaq. E ardhmja kërkon vizion, vullnet, kurajo dhe përkushtim.

Me moton “Nëse dëshironi të siguroheni, ka vetëm një emër...”, ne jemi përpjekur të jemi më afër klientëve me ato produkte që kërkojnë dhe me një shërbim përherë e më të mirë dhe më me interes për fushat e mbrojtjes së jetës, pasurive dhe shëndetit.

Besnikë ndaj klientëve dhe partnerëve tanë, kemi arritur që përmes rezultateve të shkëlqyera dhe vizionit të qartë për të ardhmen, t'i japim një tjetër dimension sigurimeve dhe të kërkojmë të

jemi gjithmonë në avangardë në të gjitha fushat për të qenë në këtë mënyrë “Sigurimi i Gjeneratës së Re”. Kjo do të thotë të jesh gjithmonë së paku një hap para të tjerëve në mënyrë të tillë që klientët tanë ta ndjejnë veten krenarë që janë pjesë e një Gjenerate të Re.

Me falënderimin ndaj punonjësve për përkushtimin dhe partnerëve për mbështetjen, shpreh bindjen dhe premtimin për një të ardhme edhe më të suksesshme për SIGAL Holding dhe rolin e padiskutueshëm në zhvillimin e tregjeve ku operon.

Avni PONARI



**CEO
SIGAL Holding**



▶ Stafi Drejtues
SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA



Rreth Kompanisë

Misioni i SIGAL Holding

Objektivi kryesor i SIGAL Holding është krijimi i stabilitetit për të gjitha palët e interesuara: klientët dhe të siguruarit, aksionerët, punonjësit, agjentët, media, administrata publike dhe Autoriteti Mbikqyrës, komuniteti lokal dhe shoqëria civile në përgjithësi.

Në parimet e punës së saj, SIGAL Holding është e angazhuar për të vepruar në përputhje me parimet e ligjshmërisë, ndershmërisë dhe korrektesës.

Misioni i SIGAL Holding në thelb të veprimtarisë ka zhvillimin e shërbimeve të

sigurimeve dhe atyre financiare si dhe të krijojë siguri dhe besim, duke kërkuar gjithmonë më të mirën në interes të aksionerëve dhe të siguruarve.


Vlerat me të cilat SIGAL Holding identifikohet dhe punon janë dinamizmi, përgjegjshmëria, shërbimi, përkujdesja ndaj klientit dhe rritja e veprimtarisë.

Të gjitha këto e bëjnë SIGAL Holding kompaninë lider në tregun në të cilin operon duke i dhënë "sigurimeve" përmasa dhe kuptime të tjera, ato të "gjeneratës së re".

Etapat e zhvillimit të Kompanisë

SIGAL sh.a u themelua në 22 shkurt 1999 me vendim të Gjykatës së Tiranës, numër 20863 dhe është shoqëria e parë në tregun shqiptar të sigurimeve që tërhoqi kapitalin e huaj.

Në vitin 2003 Fondi Shqiptaro - Amerikan i Ndërmarrjeve, fond i krijuar nga Departamenti i SH.B.A-së, u bë një nga aksionerët e SIGAL sh.a. duke zotëruar 13.3% të aksioneve. Përmes këtij partneriteti, F.SH.A.N ka mundur mbështetje financiare e menaxheriale jo vetëm për



Kompaninë por për të gjithë tregun e sigurimeve në Shqipëri.


Në muajin Mars 2007 SIGAL sh.a. nënshkroi marrëveshjen e bashkëpunimit me një prej grupeve më të fuqishme financiare në Europën Qendrore dhe Lindore, UNIQA GROUP AUSTRIA. Me një shtrirje në 24 vende të Europës Qendrore dhe Lindore ky grup zotëron aktualisht 46% të aksioneve të shoqërisë. Në këtë mënyrë, rreth 60 % e aksioneve të SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA janë kapital i huaj dhe pjesa tjetër i përket aksionerëve lokalë.

Në muajin shkurt të vitit 2006, SIGAL sh.a. krijoi të parën dhe të vetmen shoqëri të risigurimeve në Shqipëri, duke u shndërruar kështu në të parin sigurues të siguruesve shqiptarë dhe rajonalë. Aktiviteti i risigurimit filloi menjëherë, sapo

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare liçensoi shoqërinë e sigurimeve për një veprimtari të tillë.

Në këtë mënyrë, SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA është e vetmja shoqëri sigurimi private në Shqipëri, e liçensuar për sigurimin e të gjitha klasave të sigurimeve të Jo-Jetës dhe të Jetës. SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA është e para shoqëri e shpallur zyrtarisht Holding nën strukturën e së cilës ushtrojnë aktivitetin sigurues; SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA (Jo Jetë dhe Risigurime), SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Life, SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Kosova, SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Maqedoni.

Gjatë pesë viteve të fundit SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA është renditur si Shoqëria më e Madhe e Sigurimeve në Shqipëri e cila zotëron mesatarisht 30% të tregut të sigurimeve.



Sukses përmes bashkëpunimit me aktorë ndërkombëtarë



SIGAL Holding (Tiranë - Shqipëri)



UNIQA GROUP AUSTRIA (Vjenë - Austri)

Në SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA, partneriteti dhe bashkëpunimi me aktorët lokalë dhe ndërkombëtarë konsiderohet një ndër faktorët kryesorë të arritjeve. Tregues i këtij sukcesi është bashkëpunimi i gjerë me grupe të rëndësishme financiare krahas UNIQA GROUP AUSTRIA dhe Fondit Shqiptaro - Amerikan të Ndërmarrjeve. Më konkretisht, partnerët risigurues të SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA janë shoqëritë më të suksesshme në tregjet ndërkombëtare. Bashkëpunime të tilla i sigurojnë kompanisë më shumë hapësirë për një njohje gjithëpërfshirëse, ekspertizë dhe kapacitete të disponueshme në tregun botëror.

Gjithashtu, në fund të vitit 2002, SIGAL sh.a. dhe Coris International me qendër në Paris, nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi në mënyrë të tillë që klientët e kompanisë të mund të marrin asistencë në të gjitha shtetet ku ndodhen.

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA është e vetmja kompani e sigurimeve në Shqipëri, përfaqësuese e disa klubeve P&I (Protection & Indemnity). Përmes bashkëpunimit me partnerët e saj ndërkombëtarë dhe me mbështetjen e brokerave të suksesshëm, SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA ofron shërbim të plotë dhe kompleks në sigurimet e marinës sipas kushteve të Lloyd's.

Ngjarje të Rëndësishme për vitin 2008


Çmime ndërkombëtare për vitin 2008

Ritmet e zhvillimit të SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA po tregojnë që është një nga shoqëritë më të suksesshme në tregun rajonal të sigurimeve. Sikurse tre vitet e fundit, Finance Central Europe vlerësoi edhe për vitin 2008 shoqërinë me çmimin “Shoqëria më e mirë e sigurimeve në Shqipëri për vitin 2008”

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA u vlerësua gjithashtu si:

- ▶ Shoqëria më e mirë e Sigurimeve në Shqipëri për “Kthimin mbi Aktivitet”
- ▶ Shoqëria më e Mirë e Sigurimeve në Shqipëri për “Efektshmërinë e Investimit”
- ▶ Shoqëria më e Mirë e Sigurimeve në Shqipëri për “Fitimin e Realizuar”.
- ▶ Shoqëria më e mirë e Sigurimeve në Shqipëri për “Vëllimin e Primeve”

Këto vlerësime dhe shifrat gjithnjë në rritje të kompanisë reflektojnë më së miri seriozitet, besueshmëri dhe garanci për klientët.



SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Kosova: 5 vjet sukses

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Kosova mbushi 5 vjet nga aktiviteti i saj. Në një konferencë për shtyp, Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL Holding, z. Avni Ponari, Kryetari i F.SH.A.N

dhe njëkohësisht Kryetar Bordi Mbikqyrës të SIGAL Holding, z. Jeffrey Griffin si dhe Anëtari i Bordit Menaxhues të UNIQA GROUP AUSTRIA, z. Andreas Brandstetter, treguan arritjet dhe

synimet e shoqërisë në Kosovë.

SIGAL sh.a., në vitin 2003, bleu shoqërinë e sigurimeve "Drini" dhe sot ka mbi 60 mijë klientë në gjithë Kosovën, duke mbajtur vendin e tretë në tregun kosovar të sigurimeve. SIGAL sh.a. Kosova u liçensua nga Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës, në vitin 2003, si Kompani Jo Jetë, për sigurime të përgjithshme. Sot SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Kosova ofron shëbimin e saj në të gjithë territorin e Kosovës përmes 50 zyrave në qytetet kryesore.



Gjatë ceremonisë së 5-vjetorit të SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Kosova

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Maqedoni përruron zyrat e reja

SIGAL a.d u liçensua në 30 Gusht 2004 nga Ministria Maqedonase e Financave dhe filloi aktivitetin e saj dy muaj më vonë për të gjitha klasat e sigurimit të jo-jetës. Në Maqedoni operojnë 10 kompani sigurimi për produktet e jo-jetës dhe 2 kompani jete.

Për vitin 2008, SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Maqedonia u pozicionua në tregun maqedonas të sigurimeve të detyrueshme me mesatarisht 10% të primeve dhe pati një rritje prej 16% në krahasim me një vit më parë në të njëjtat produkte.

Viti 2008 shënoi hapjen e zyrave të reja të SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Maqedoni në Shkup dhe 20 zyra në qytete të tjera. Në këtë mënyrë, SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Maqedoni



Gjatë ceremonisë së inagurimit të zyrave të reja në Shkup

vazhdon të rritet dhe të përmisojë shërbimin ndaj klientëve përmes zyrave në 25 qytete dhe mbi 150 agentëve në të gjithë Maqedoninë.

Krijohet fondi i ndihmës për Gërdecin

Dy ditë pas tragjedisë së Gërdecit, pikërisht më 17 mars 2008, u krijua fondi i ndihmës për familjet e dëmtuara. SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA së bashku me UNIQA GROUP AUSTRIA, Fondi Shqiptaro - Amerikan i Ndërmarrjeve, Banka Amerikane e Shqipërisë dhe "Kalo Associates", duke ndjekur me shqetësim situatën e krijuar në Gërdec, filluan krijimin e një fondi në ndihmë të familjeve të dëmtuara në zonën e shpërthimit. Të pesta subjektet krijuan një fond prej 55 mijë euro, duke i bërë thirrje të gjitha subjekteve brenda dhe jashtë Shqipërisë, për të kontribuar në ndihmë të familjeve të prekura nga tragjedia.



Momenti i mbërritjes së medikamenteve spitalore nga UNIQA GROUP AUSTRIA

Krahas ndihmës të dhënë financiare, kompania UNIQA GROUP AUSTRIA solli në Shqipëri medikamente spitalore dhe i ofroi qeverisë shqiptare ndihmë në transportimin dhe kurimin e të plagosurve në spitalet e Vjenës.

Organizohet Konferenca e 5-të Rajonale në Egjipt


Në datat 6-9 Nëntor, në Sharm El Sheikh u organizua Konferenca e 5-të Rajonale për SIGAL Holding. Ndryshe nga Konferencat e mëparshme, në këtë takim morën pjesë të gjithë përfaqësuesit e aksionerëve të SIGAL Holding. Organizuar nën kujdesin e Drejtorit të Përgjithshëm të SIGAL Holding, z. Avni Ponari, në konferencë ishin të pranishëm z. Jeffrey Griffin, Kryeta i Bordit Mbikëqyrës SIGAL Holding dhe z. Andreas Brandstetter, Anëtar i Bordit Menaxhues UNIQA GROUP AUSTRIA.




Stafi i SIGAL Holding në Konferencën e 5-të Rajonale në Sharm El Sheikh

SIGAL Holding

Totali vjetor i Primeve SIGAL Holding (5 vjet)



	2004	2005	2006	2007	2008
Total	€ 14,339,200	€ 15,980,600	€ 19,340,600	€ 23,445,500	€ 27,663,700
Shqipëri	€ 10,192,500	€ 9,434,700	€ 10,174,400	€ 13,615,900	€ 16,246,300
Kosovë	€ 4,009,700	€ 4,194,700	€ 5,160,000	€ 5,304,800	€ 6,085,400
Maqedoni	€ 137,000	€ 2,351,200	€ 4,006,200	€ 4,524,800	€ 5,332,000




SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA

Jo - Jetë Shqipëri


Tregu Shqiptar i Sigurimeve

Raporti vjetor i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare e rendit SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA në vendine parë përse i përket ndarjessë tregut. E thënë në shifra, SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA udhëhoqi tregun shqiptar të sigurimeve të Jo-Jetës me 27.16% të primeve.

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA është gjithashtu në kryetë renditjes me 28.89% dëmetë paguara për Sigurimet Jo-Jetë





Dëmet e paguara për 2008



Totali vjetor i Primeve të SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA në Shqipëri (5 vjet)

	2004	2005	2006	2007	2008
Total	€ 10,192,500	€ 9,434,700	€ 10,174,400	€ 13,615,900	€ 16,246,300
Jetë, AP & Shëndet	€ 600,700	€ 875,900	€ 1,158,600	€ 1,634,000	€ 2,520,900
Motorike	€ 7,058,700	€ 5,744,400	€ 6,306,300	€ 8,728,600	€ 8,770,000
Marinë & Aviacion	€ 868,100	€ 403,300	€ 534,300	€ 461,700	€ 673,500
Pasuri & Përgjegjësi	€ 987,800	€ 1,839,100	€ 1,689,300	€ 2,271,500	€ 3,606,600
Garancive	€ 677,200	€ 572,000	€ 485,900	€ 520,100	€ 675,300



SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Life

Në fund të vitit 2008, SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Life numëroi tre vjet nga fillimi i aktivitetit në tregun shqiptar të sigurimeve. Edhe pse një aktivitet më vete, SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Life ka ndjekur hapat e SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA (Jo-Jetë) duke arritur rezultate pozitive në drejtim të rritjes vjetore dhe ndarjes së tregut. Që në vitin 2007, SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Life kryesoi tregun e sigurimeve për aktivitetin e jetës ndërkohë që volumi i primeve për vitin 2008 u rrit me 32% (rritja e tregut ishte 26%) që do të thotë zotërimin e më se 40% të tregut.

Gjatë vitit 2008 SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Life

pagoi më shumë se gjysmën e dëmeve të tregut të sigurimeve të jetës, e thënë ndryshe: 38% më shumë se në vitin 2007.

Janë hartuar dhe zbatuar produkte të reja të sigurimit përmes bankave me mbështetjen e veçantë të stafit për këto produkte të UNIQA GROUP AUSTRIA. Qëllimi i këtyre produkteve është krijimi i rrjeteve të shitjeve të integruara me bankat kryesore. Gjatë vitit 2008 vëmendja është përqendruar në hartimin e skemave të kursimit afatgjatë. Këto produkte po shiten me sukses dhe në përputhje me eksperiencën e UNIQA GROUP AUSTRIA në vendet e tjera të rajonit.

Zhvillimi i tregut të sigurimeve të jetës

Sigurimi i jetës përbën një nga sektorët kryesorë të tregut të sigurimeve në vendet e industrializuara. Në ekonominë në zhvillim, sigurimi i jetës po zhvillohet me ritme të shpejta. Pavarësisht vështirësive financiare të vitit 2008 volumi i primeve për sigurimin e jetës në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore u rrit me 18%.

Në Shqipëri, tregu i sigurimit të jetës vazhdon të jetë në fazat fillestare dhe zhvillimi i mëtejshëm i tij varet nga disa faktorë. Disa prej tyre si: disponueshmëria e produkteve dhe shërbimeve, rritja e ndërgjegjësimit publik dhe përmirësimi i kanaleve të shpërndarjes janë përgjegjësi e kompanive të sigurimit dhe adresohet vazhdimisht prej tyre.

Hyrja në treg e sigurveve të huaj të cilat kanë njohuri dhe aftësi veçanërisht në fushën e sigurimit të

jetës dhe shëndetit, po përshpejton zhvillimin dhe mundëson një bazë të fuqishme financiare për sigurimin të jetës në Shqipëri.

Një faktor kyç për zhvillimin e sigurimit të jetës në çdo vend është situata ekonomike e cila ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë aftësinë blerëse të popullatës për produktet e jetës dhe investimin për të ardhmen.

Treguesit ekonomik në Shqipëri kanë qënë domethënëse. Prodhimi i Përgjithshëm Bruto (PBP) në total dhe PBP për frymë janë rritur dhe parashikimi për të ardhmen është pozitiv.

Faktori i vetëm i cili deri më tani po ndikon negativisht në zhvillimin e tregut të sigurimit të jetës në Shqipëri është mjedisi i pafavorshëm fiskal. Edhe pse për primet nga sigurimet e jetës nuk aplikohet T.V.SH (siç ndodh për primet nga sigurimet e jo-jetës), nuk


ekzistojnë politika nxitëse fiskale as në nivel individual dhe as në nivel kompanie siç ndodh në të gjithë vendet Europiane. Gjithashtu, një çështje e rëndësishme

mbetet taksimi i njëtrajtshëm mbi fitimin nga policat e sigurimit të jetës i cili i bën këto produkte më pak tërheqëse për publikun.


Ndarja e Tregut SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA për 2008 (nga AMF)

Gjatë vitit 2008 SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Life kryesoi sërish tregun shqiptar për Sigurimin e Jetës duke zotëruar 40.34% të tij për nga volumi i përgjithshëm i primeve.

Përsa i përket dëmshtëpërblimeve, raporti vjetor i A.M.F e pozicionon SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Life gjithashtu në vend të parë me 51.65% dëmet të paguara.



Dëmet e paguara për 2008




SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA

Kosova

Tregu Kosovar i Sigurimeve

Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për tregun e sigurimeve në vend, 2008 kashënuar një rritje të përgjithshme të volumit të primeve me rreth 17.2%.

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Kosova, 5 vjet pas krijimit, renditet e treta ndër 10 kompanitë e pranishme duke zotëruar 13.4% të tregut të sigurimeve Jo-Jetë dhe me një rritje prej 13%.





SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Kosova zë 13.4% të tregut

Sipas klasave të sigurimit:

- 14% tregu i sigurimeve Motorike, TPL
- 13% klasat e tjera të sigurimeve

Totali vjetor i Primeve të SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Kosova (5 vjet)

	2004	2005	2006	2007	2008
Total	€ 4,009,700	€ 4,194,700	€ 5,160,000	€ 5,304,800	€ 6,085,400
AP & Shëndet	€ 9,500	€ 92,200	€ 68,200	€ 59,200	€ 165,600
Motorike	€ 3,663,400	€ 3,867,200	€ 4,761,800	€ 4,971,900	€ 5,235,400
Marinë & Aviacion	0	0	0	€ 400	€ 35,100
Pasuri & Përgjegjësi	€ 336,800	€ 235,300	€ 126,600	€ 107,400	€ 300,400
Garancive	0	0	€ 203,400	€ 165,900	€ 348,900




SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Maqedoni

Tregu Maqedonas i Sigurimeve

Nisur nga të dhënat e Ministrisë së Financave në Maqedoni mbi tregun e sigurimeve, SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Maqedoni zotëron 4% të

tij. Sikurse tregjet e tjerë, edhe ai maqedonas dominohet nga TPL, të ardhurat nga të cilat përbëjnë 7% të primeve totale të kompanisë.





SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Maqedoni zë 4% të tregut

Sipas klasave të sigurimit:

- 7% tregu i sigurimeve Motorike, TPL
- 1% tregu i sigurimeve Jetë, Aksidente Personale dhe Shëndet
- 1% klasat e tjera të sigurimeve

Totali vjetor i Primeve të SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Maqedoni (5 vjet)

	2004	2005	2006	2007	2008
Total	€ 137,000	€ 2,351,200	€ 4,006,200	€ 4,524,800	€ 5,332,000
Jetë, AP & Shëndet	€ 15,600	€ 158,100	€ 251,100	€ 195,900	€ 316,700
Motorike	€ 111,500	€ 1,879,300	€ 3,414,900	€ 4,013,100	€ 4,463,200
Marinë & Aviacion	0	€ 10,700	€ 700	€ 5,900	€ 12,700
Pasuri & Përgjegjësi	9,900	€ 303,100	€ 339,500	€ 300,400	€ 539,400
Garancive	0	0	0	€ 9,500	0



- TPL
- Jetë, Aksidente Personale dhe Shëndet
- Kasko
- Pasuri dhe Përgjegjësi
- Të gjitha llojet e Garancive
- Marinë dhe Aviacion



Totali i Primeve /
Total Premium

€ 27.7 milion

Rritja Vjetore /
Annual Growth

17%



Të dhëna Financiare / Financial Data 2008

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA (Jo- Jetë / Non-Life)

Punonjës në Total / Total Employees 116

Punonjës në Drejtori / Head Office Employees 45

Punonjës në Degë / Branches Employees 71

Agjentë / Agents 385

Vëllimi i Primeve / Gross Premium € 14,544,790

Primi Neto / Net Premium € 12,716,189

Përfitimi Neto (përfshirë taksat) € 1,854,846
Net profit (after tax)

Kapitali / Equity € 13,261,507

Vëllimi i Primeve / Kapitali 1.10
Gross premium / Equity

Primi Neto / Kapitali 0.96
Net Premium / Equity

Efektshmëria e investimeve / ROE 14.0%

SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA

Punonjës në Total / Total Employees 14

Punonjës në Drejtori / Head Office Employees 10

Punonjës në Degë / Branches Employees 4

Agjent / Agents 52

Vëllimi i Primeve / Gross Premium € 1,701,580

Primi Neto / Net Premium € 1,356,864

Përfitimi Neto (përfshirë taksat) € 597,753
Net profit (after tax)

Kapitali / Equity € 3,790,028

Vëllimi i Primeve / Kapitali 0.45
Gross premium / Equity

Primi Neto / Kapitali 0.36
Net Premium / Equity

Efektshmëria e investimeve / ROE 15.8%



Kapitali / Equity
€ 19.2 milion

Fitimi Neto / Net Profit
€ 3.5 milion



**SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA
 Kosova**

Punonjës në Total / Total Employees 56

Punonjës në Drejtori / Head Office Employees 31

Punonjës në Degë / Branches Employees 25

Agjentë / Agents 38

Vëllimi i Primeve / Gross Premium € 6,085,367

Primi Neto / Net Premium € 5,570,626

**Përfitimi Neto (përfshirë taksat)
 Net profit (after tax)** € 605,767

Kapitali / Equity € 3,605,767

**Vëllimi i Primeve / Kapitali
 Gross premium / Equity** 1.69

**Primi Neto / Kapitali
 Net Premium / Equity** 1.55

Efektshmëria e investimeve / ROE 16.8%

**SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA
 Maqedoni / Macedonia**

Punonjës në Total / Total Employees 58

Punonjës në Drejtori / Head Office Employees 26

Punonjës në Degë / Branches Employees 32

Agjentë / Agents 157

Vëllimi i Primeve / Gross Premium € 5,331,950

Primi Neto / Net Premium € 4,761,546

**Përfitimi Neto (përfshirë taksat)
 Net profit (after tax)** € 383,941

Kapitali / Equity € 3,999,177

**Vëllimi i Primeve / Kapitali
 Gross premium / Equity** 1.33

**Primi Neto / Kapitali
 Net Premium / Equity** 1.19

Efektshmëria e investimeve / ROE 9.6%

RAPORT I PAVARUR I AUDITIT

Drejtuar aksionerëve dhe drejtuesve të SIGAL Holding sh.a:

1. Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëlidhur të SIGAL Holding sh.a (Grupi), të cilat përmbajnë bilancin kontabël më datë 31 Dhjetor 2008, dhe pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve të kapitalit, dhe pasqyrën e fluksit të parasë për ushtrimin e mbyllur në këtë datë, dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe shënime të tjera sqaruese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Lëvizjet Financiare

2. Drejtuesit janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje të plotë me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe ruajtjen e kontrollit të brendshëm i cili është i rëndësishëm për përgatitjen dhe paraqitjen e saktë të pasqyrave financiare pa anomali materiale si pasojë e mashtrimit apo gabimeve, përzgjedhjen dhe zbatimin e politikave kontabël të duhura dhe të bëjë të mundur që vlerësimet kontabël të jenë të arsyeshme për rrethanat.

Përgjegjësia e Audituesve

3. Përgjegjësia jonë është që, duke u bazuar në auditivin tonë, të shprehim një opinionin në lidhje me pasqyrat financiare. Me përjashtim të specifikave të përshkruara në paragrafin 6, auditimi që kryejmë bazohet në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto Standarde kërkojnë që ne tu përmbahemi kërkesave etike të përshtatshme, dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të fituar siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale.

4. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencë që mbështet tepricat dhe informacionet e dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura janë në varësi të gjykimit të audituesit, përfshirë këtu vlerësimin e rrethave të anomalive materiale në pasqyrat financiare si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Në kryerjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi shqyrton kontrollin e brendshëm, i cili është i rëndësishëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por që nuk kanë për qëllim shprehjen e një opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve kontabël të përdorura dhe të vlerësimeve të rëndësishme të bëra nga Drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

5. Me përjashtim të specifikave të përshkruara më poshtë në paragrafin 6, ne besojmë se evidenca e auditimit jep një bazë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për opinionin tonë.

Baza e Kualifikimit

6. Sikurse u përmend në shënimin 2d (iii), kompanitë vartëse nuk përgatitën pasqyra financiare në kohën kur SIGAL Holding mori drejtimin e tyre dhe si pasojë, pasqyra e të ardhurave dhe ajo e qarkullimit të parasë u përgatitën përmes shpërndarjes së pasqyrës financiare duke përdorur metodën e vijës së drejtë për periudhën e drejtimit. Gjithsesi, kjo metodë nuk reflekton saktësisht shumën e të ardhurave, shpenzimeve dhe qarkullimit të parasë nga momenti i marrjes së drejtimit deri në 31 Dhjetor 2007. Për rrjedhojë, pasqyra e të ardhurave dhe ajo e qarkullimit të parasë për vitin që përfundoi në 31 Dhjetor 2007, mund të kenë anomali materiale.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të rregullimeve të mundshme, nëse ka, lidhur me shifrat e pasqyruara deri në 31 Dhjetor 2007 dhe pyetjes nëse ne ishim në gjendje të gjenim përgjigje për çështjet e përmendura në paragrafin 6; pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë të gjendjes financiare të Grupit deri më datë 31 Dhjetor 2008, si dhe të rezultateve të veprimtarisë së tij, dhe lëvizjen e parasë për vitin që u mbyll, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportit Financiar.

Tiranë, Shqipëri
25 Maj 2009

INDEPENDENT AUDITOR'S REPORT

To the shareholders and management of SIGAL HOLDING sh.a:

1. We have audited the accompanying consolidated financial statements of SIGAL Holding sh.a (the "Group"), which comprise the balance sheet as at December 31, 2008, and the income statement, statement of changes in equity and cash flow statement for the year then ended, and a summary of significant accounting policies and other explanatory notes.

Management's Responsibility for the consolidated Financial Statements

2. Management is responsible for the preparation and fair presentation of these consolidated financial statements in accordance with International Financial Reporting Standards. This responsibility includes: designing, implementing and maintaining internal control relevant to the preparation and fair presentation of consolidated financial statements that are free from material misstatement, whether due to fraud or error; selecting and applying appropriate accounting policies; and making accounting estimates that are reasonable in the circumstances.

Auditor's Responsibility

3. Our responsibility is to express an opinion on these consolidated financial statements based on our audit. Except as discussed in the paragraph 6 below, we conducted our audit in accordance with International Standards on Auditing. Those standards require that we comply with ethical requirements and plan and perform the audit to obtain reasonable assurance whether the consolidated financial statements are free from material misstatement.

4. An audit involves performing procedures to obtain audit evidence about the amounts and disclosures in the consolidated financial statements. The procedures selected depend on the auditor's judgment, including the assessment of the risks of material misstatement of the consolidated financial statements, whether due to fraud or error. In making those risk assessments, the auditor considers internal control relevant to the entity's preparation and fair presentation of the consolidated financial statements in order to design audit procedures that are appropriate in the circumstances, but not for the purpose of expressing an opinion on the effectiveness of the entity's internal control. An audit also includes evaluating the appropriateness of accounting policies used and the reasonableness of accounting estimates made by management, as well as evaluating the overall presentation of the consolidated financial statements.

5. Except as discussed in paragraph 6 below, we believe that the audit evidence we have obtained is sufficient and appropriate to provide a basis for our qualified audit opinion.

Basis of Qualification

6. As described in Note 2d (iii) the subsidiaries of the Company did not prepare financial statements on the date that SIGAL Holding assumed control over them and as a result the consolidated income statements of the subsidiaries using the straight line method for the period of control. This method however may not reflect accurately the amount of revenue, expenses and cash flows incurred during the period from assuming of control until December 31, 2007. As a result the consolidated income and cash flow statements for the year ended December 31, 2007 may be materially misstated.

Opinion

In our opinion, except for the effects of potential adjustments on the corresponding figures as at December 31, 2007, if any, as might be required had we been able to satisfy ourselves on the matters referred to in paragraph 6, the accompanying consolidated financial statements present fairly, in all material respects, the financial position of the Group as of December 31, 2008, its financial performance and its cash flows for the year then ended in accordance with International Financial Reporting Standards.



Tirana, Albania
May 25, 2009

Bilanci Financiar

Consolidated Balance sheet

deri në 31 Dhjetor 2008 / as at December 31, 2008

(të gjitha shifrat janë në mijë ('000) LEKË, me përjashtim të rasteve të specifikuara)
(all amounts are expressed in thousand ALL, unless otherwise stated)

		Shënime Notes	Deri në 31 Dhjetor / As at December 31 2008	Deri në 31 Dhjetor / As at December 31 2007
AKTIVET	ASSETS			
Prona dhe pajisjet	Property, plant and equipment	4	810,568	737,576
Aktivitet financiare	Financial assets	5	2,664,766	2,092,203
Arkëtimi nga sigurimet	Insurance receivables	6	425,591	556,782
Aktive të tjera	Other assets	7	24,830	18,510
Inventari	Inventory		17,781	4,736
Aktivitet e taksës së shtyrë	Deferred tax assets	8	-	2,534
Kontarta Risigurimi	Reinsurance contracts	9	82,363	29,786
Kostoja e shtyrë e blerjeve	Deferred acquisition costs	10	85,305	37,357
Mjetet financiare të mbajtura deri në maturim	Held to maturity financial assets	11	58,556	-
Tatimi mbi fitimin	Current income tax asset		2,710	135
Mjete monetare dhe të ngjashme	Cash and cash equivalents	12	497,218	493,509
AKTIVET TOTALI	TOTAL ASSETS		4,669,688	3,973,128
KAPITALI	EQUITY			
Kapitali dhe rezervat e kapitalit të aksionerëve	Capital and reserves attributable to the Company's equity holders	13	1,241,830	1,241,830
Aksionet bazë	Ordinary shares	14	68,708	9,329
Rezerva të tjera të kapitalit	Other capital reserves	15	43,163	27,208
Rezervat ligjore	Legal reserve		338	(7,608)
Diferenca rivlerësimit	Translation reserves	16	-	426,490
Rezervat që i kalohen kapitalit	Reserves transferred directly to equity		930,993	418,621
Fitimi i mbajtur	Retained earnings		2,285,032	2,115,870
Interesi i pakicës	Minority Interest		34	30
KAPITALI TOTAL	TOTAL EQUITY		2,285,066	2,115,900
DETYRIMET	LIABILITIES			
Kontrata sigurimi	Insurance contracts	17	2,161,066	1,688,874
Huamarrjet	Borrowing	18	-	1,789
Masat për detyrimet dhe pagesa të tjera	Provisions for other liabilities and charges	19	-	24,352
Tregtia dhe pagesa të tjera	Trade and other payables	20	155,705	114,051
Pagesat nga aktiviteti risigurues	Payables from reinsurance activity	21	17,054	17,740
Përqindja aktuale e detyrimeve afatgjatë	Current portion of long term debt		220	-
Tatimi mbi fitimin	Current income tax liabilities		50,577	10,422
DETYRIMET TOALE	TOTAL LIABILITIES		2,384,622	1,857,228
KAPITALI DHE DETYRIMET TOALE	TOTAL EQUITY AND LIABILITIES		4,669,688	3,973,128

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Drejtorët e Kompanisë më 20 Maj 2009 dhe nënshkruar nga:

These financial statements have been approved by the Directors of the Company on May 20, 2009 and signed on its behalf by:

Avni PONARI



CEO

Klement MERSINI



Drejtor i Departamentit të Financës /
Director of Finance Department

Pasqyra e të Ardhurave

Consolidated Income Statement

deri në 31 Dhjetor 2008 / as at December 31, 2008

(të gjitha shifrat janë në mijë ('000) LEKË, me përjashtim të rasteve të specifikuara)
(all amounts are expressed in thousand ALL, unless otherwise stated)

			Për vitin që përfundoi në 31 Dhjetor 2008	Për periudhën 21 mars (Data e fillimit) deri në 31 Dhjetor 2007
		Shënime Notes	For the year ending December 31, 2008	For the period from March 21, 2007 (inception date) to December 31, 2007
Të ardhurat nga primet	Insurance premium revenue	22	3,184,314	1,872,124
Primet e sigurimit për ri-siguruesit	Insurance premium ceded to reinsurers	22	(255,709)	(202,078)
Të ardhurat neto për primet	Net insurance premium revenue		2,928,605	1,670,046
Tarifat e ardhura nga kontratat e sigurimit	Fee income from insurance contracts		-	4,205
Të ardhurat nga investimet	Investment income		116,393	63,781
Të ardhura të tjera operative	Other operating income	23	29,870	21,020
Të ardhurat neto	Net income		3,074,868	1,759,052
Fitimi neto nga sigurimet dhe dëmet	Net insurance benefits and claims	24	(1,258,102)	(483,263)
Shpenzimet për blerjen e kontratave të sigurimit dhe investimit	Expenses for the acquisition of insurance and investment contracts	25	(353,074)	(166,087)
Shpenzimet për marketing dhe administratën	Expenses for marketing and administration	26	(828,498)	(438,397)
Shpenzime të tjera operative	Other operating expenses	27	(288,226)	(226,271)
Shpenzimet	Expenses		(2,727,900)	(1,314,018)
Rezultatet të aktiviteteve operative	Results of operating activities		346,968	445,034
Kosto Financiare	Finance costs		-	(4,512)
Fitimi / Humbjet nga kursi i këmbimit	Foreign exchange gain / (loss)		123,707	(88,430)
Fitimi pa taksat	Profit before tax		470,675	352,092
Shpenzimet për tatim mbi fitimin	Income tax expense	28	(92,185)	(61,110)
Fitimi për vitin	Profit for the year		378,490	290,982
Në ngarkim të:	Attributable to:			
Kapitali i aksionerëve kryesorë	Equity holders of the parent		378,486	290,952
Interesi i pakicës	Minority interest		4	30

Pasqyra e Ndryshimit të Kapitalit

Consolidated Statement of changes in Equity

		Aksionet bazë	Rezerva të tjera të kapitalit	Rezervat e stabilizimit
		Ordinary shares	Other capital reserves	Equalization reserve
Ekulibri fillestar	Opening balance	2,000	-	159,295
Dividenti i paguar	<i>Dividends paid</i>	-	-	-
Rritja e kapitalit	<i>Share capital increase</i>	1,075,597	-	-
Rezerva të tjera të kapitalit	<i>Other capital reserves</i>	-	9,329	-
Përvetësimi i fitimit të mbajtur	<i>Appropriation of retained earnings</i>	164,233	-	-
Rritja e rezervave	<i>Increase in reserves</i>	-	-	4,682
Fitimi për vitin	<i>Profit for the year</i>	-	-	-
Rregullimi i diferencës së rivlerësimit	<i>Translation adjustment</i>	-	-	-
Deri në 31 Dhjetor 2007	As at December 31, 2007	1,241,830	9,329	163,977
Përvetësimi i fitimit të mbajtur	<i>Appropriation of retained earnings</i>	-	59,379	-
Rritja e rezervave	<i>Increase in reserves</i>	-	-	-
Përvetësimi i rezervave për fitimin e mbajtur	<i>Appropriation of reserves to retained earnings</i>	-	-	(163,977)
Fitimi për vitin	<i>Profit for the year</i>	-	-	-
Shpërndarja e dividendit	<i>Dividend distribution</i>	-	-	-
Rregullimi i diferencës së rivlerësimit	<i>Translation adjustment</i>	-	-	-
Interesi i kapitalit aksioner të pakicës	<i>Minority interest share capital</i>	-	-	-
Deri në 31 Dhjetor 2008	As at December 31, 2008	1,241,830	68,708	

deri në 31 Dhjetor 2008 / as at December 31, 2008

(të gjitha shifrat janë në mijë ('000) LEKË, me përjashtim të rasteve të specifikuara)
(all amounts are expressed in thousand ALL, unless otherwise stated)

Rezervat e katastrofave	Rezervat ligjore	Korrigjimet e transfertave	Fitimi i mbajtur	Në ngarkim të kapitalit të aksionerëve kryesorë	Interesi i pakicës	Totali
<i>Catastrophe reserve</i>	<i>Legal Reserve</i>	<i>Translation adjustment</i>	<i>Retained earnings</i>	<i>Attributable to equity holders of the parent</i>	<i>Minority interest</i>	<i>Total</i>
269,815	27,683	(3,596)	436,981	892,178	-	892,178
-	-	-	(143,000)	(143,000)	-	(143,000)
-	-	-	-	1,075,597	-	1,075,597
-	-	-	(9,329)	-	-	-
-	-	-	(164,233)	-	-	-
(7,303)	-	-	2,620	-	-	-
-	-	-	290,952	290,952	30	290,982
-	(475)	(4,012)	4,629	142	-	142
262,512	27,208	(7,608)	418,621	2,115,870	30	2,115,900
-	-	-	(59,379)	-	-	-
-	15,592	-	(15,592)	-	-	-
(262,512)	-	-	426,489	-	-	-
-	-	-	378,486	378,486	4	378,490
-	-	-	(215,145)	(215,145)	-	(215,145)
-	363	7,946	(2,453)	5,855	-	5,855
-	-	-	(34)	(34)	-	(34)
	43,163	338	930,993	2,285,032	34	2,285,066

Pasqyra e Qarkullimit të Parave

Consolidated Cash Flow Statement

deri në 31 Dhjetor 2008 / as at December 31, 2008

(të gjitha shifrat janë në mijë ('000) LEKË, me përjashtim të rasteve të specifikuara)
(all amounts are expressed in thousand ALL, unless otherwise stated)

		Për vitin që përfundoi në 31 Dhjetor 2008 For the year ending December 31, 2008	Për periudhën 21 mars (Data e fillimit) deri në 31 Dhjetor 2007 For the period from March 21, (inception date) to December 31, 2007
Qarkullimi i parave gjatë aktiviteteve operative	Cash flows from operating activities	470,675	352,092
Përfitimi pa shpezimet për taksat	Profit before income tax expense		
Rregullat për të lidhur fitimin neto me lëvizjen neto të parave nga aktivitetet operative	Adjustments to reconcile net profit to net cash flows from operating activities:		
Zhvlërësimet dhe amortizimet	Depreciation and amortisation	48,125	36,408
Pasuri dhe pajisje të shkruara	Property and equipment written off	255	61,957
Ndryshime në parashikimet e kontratave të sigurimit	Change in insurance contract provisions	472,192	131,735
Risigurime të rikuperueshme	Reinsurance recoverable	(52,577)	53,316
Detyrimet nga dëmtimet	Impairment charge	101,846	38,898
Të ardhurat nga interesi	Interest income	(63,781)	(63,781)
Shpenzimet e interesit	Interest expense	-	4,512
Ndikimi i transferimeve	Translation effect	(6,481)	(7,608)
Lëvizja e parave nga fitimi operativ përpara ndryshimeve në kapitalin dhe borxhet operative	Cash flows from operating profits before changes in operating assets and liabilities	970,254	607,529
Ulja (Rritja) në sigurimet që janë për tu marrë	Decrease (Increase) in insurance receivables	106,399	(15,947)
Ulja në taksën e shtyrë	Decrease in deferred tax asset	2,534	1,364
Rritja në inventar	Increase in inventory	(13,045)	-
Rritja në kapitale të tjera	Increase in other assets	(24,830)	-
Rritja në koston e shtyrë të blerjes	Increase in deferred acquisition costs	(47,948)	(5,665)
Rritja në mbajtjen e Kapitaleve Financiare	Increase in Held to Maturity financial assets	(58,556)	-
(Ulja) Rritja në kapitalet e taksave mbi të ardhurat	(Decrease)/Increase in income tax asset	(2,575)	158
Ulja në arkëtimet nga aksionerët	Decrease in receivables from shareholders	-	2,295
Rritja në Tregti dhe Pagesa të tjera	Increase in Trade and other payables	41,654	11,667
Rritja e furnizimeve	Increase in Provisions	-	17,213
(Ulja) Rritja nga pagesat në aktivitetin risiguroes	(Decrease)/Increase in Payables from reinsurance activity	(686)	5,470
Ulja në detyrimet e shtyra të taksave	Decrease in deferred tax liability	-	(368)
Rritja në detyrimet aktuale të taksave	Increase in Current Income tax liability	40,155	5,805
Interesi i përfutur	Interest received	63,781	52,167
Interesi i paguar	Interest paid	-	(4,512)
Tatim mbi fitimin të paguara	Income tax paid	(92,185)	(50,690)
Lëvizja e parave nga aktiviteti operues	Cash flow generated from operating activities	984,952	626,486
Lëvizja e parave nga aktiviteti investues	Cash flows from investing activities		
Blerja e pronave dhe pajisjeve	Purchases of property and equipment	(176,374)	(173,913)
Rritja e depozitave me afat	Increase in term deposits	(572,563)	(630,266)
Paratë e përdorura në aktivitet investues	Cash flows used in investing activities	(748,937)	(804,179)
Paratë e përdorura nga aktiviteti financues	Cash flows from financing activities		
Interesi për marrjen e huave	Interest bearing borrowings	(1,789)	1,306
Rritja (Ulja) në detyrimin LT	Increase/(Decrease) in current portion of LT debt	220	-
Rritja e aksioneve	Share capital increase	-	498,430
Rritja në rezerva	Increase in reserves	(15,592)	-
Dividenti i paguar	Dividends paid	(215,145)	(143,000)
Lëvizja e parave nga aktiviteti financues	Cash flows generated from financing activities	(232,306)	356,736
Rritja neto e mjeteve monetare dhe të ngjashme	Net increase in cash and cash equivalents	3,709	179,044
Mjete monetare dhe të ngjashme në fillim të vitit	Cash and cash equivalents at beginning of the year	493,509	314,465
Mjete monetare dhe të ngjashme në fund të vitit	Cash and cash equivalents at end of the year (Note 12)	497,218	493,509

Parashikime / Forecast 2009

SIGAL Holding

Euro

